



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

PLANI I VEPRIMIT 2024 Federata e Basketbollit të Kosovës

Përgatiti:

Elvira DUSHKU

Sekretare e Përgjithshme
Federata e Basketbollit të Kosovës

27.12.2023, Prishtinë



PËRMBAJTJA

Për Federatën e Basketbollit të Kosovës	4
Vizioni, misioni dhe vlerat e Federatës së Basketbollit të Kosovës.....	6
Hyrje.....	9
Grupet e Interesit	10
Analiza SWOT.....	11
Objektivat Strategjike.....	12
1. Garat e FBK-së.....	13
1.1. Plani i Veprimit	13
1.2. Kontrolli dhe Vlerësimi.....	13
2. Klubet dhe anëtarët e saj.....	14
2.1. Plani i Veprimit	14
2.2. Kontrolli dhe Vlerësimi.....	14
3. Aktivitetet e Përfaqësueseve të Kosovës	15
3.1. Plani i Veprimit	15
3.2. Kontrolli dhe Vlerësimi.....	15
4. Aktivitetet e basketbollit 3x3	16
4.1. Plani i Veprimit	16
4.2. Kontrolli dhe Vlerësimi.....	16
5. Aktivitetet për trajnerët	17
5.1. Plani i Veprimit	17
5.2. Kontrolli dhe Vlerësimi.....	17
6. Aktivitetet për gjyqtarë/vëzhgues.....	18
6.1. Plani i Veprimit	18
6.2. Kontrolli dhe Vlerësimi.....	19



7. Projektet zhvillimore.....	20
7.1. Plani i Veprimit	20
7.2. Kontrolli dhe Vlerësimi.....	21
8. Projekti "Safeguarding the Future"	22
8.1. Plani i Veprimit	22
8.2. Kontrolli dhe Vlerësimi.....	23
9. Ngritja e kapaciteteve njerëzore	24
9.1. Plani i Veprimit	24
9.2. Kontrolli dhe Vlerësimi.....	24
10. Udhëtimet zyrtare	25
10.1. Plani i Veprimit.....	25
10.2. Kontrolli dhe Vlerësimi	25
11. Organizimi i eventeve dhe aktivitetet tjera	26
11.1. Plani i Veprimit.....	26
11.2. Kontrolli dhe Vlerësimi	27
12. Aktet Normative të FBK-së	28
12.1. Plani i Veprimit.....	28
12.2. Kontrolli dhe Vlerësimi	29
Rekomandimet.....	30
Përmbledhje.....	31



PËR FEDERATËN E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) është federata e dytë më e madhe në vendin tonë dhe përgjegjëse për organizimin e sportit më të shikuar dhe më të popullarizuar në Kosovë që nga viti 1999.

FBK në gjirin e saj i ka rreth 129 klube, prej tyre rreth 89 janë të kategorive të reja (U12, U14, U16, U18) në të dyja konkurrencat.

FBK organizon nën ombrellën e saj 19 liga të rregullta të kategorive të ndryshmeⁱ, gara shkollore, ligën Junior NBA, gara elitare në disiplinën 3x3, si dhe gara për të punësuarit, dhe ka të regjistruar rreth 2500 basketbolliste e basketbollistë. Krahas garave kampionale, FBK organizon garat e Kupës së Republikës për të gjitha grupmoshat dhe gjinitë dhe është bashkëthemeluese dhe organizatore e Ligës Unike - si ligë e parë sportive mbarëkombëtare e organizuar me Federatën Shqiptare të Basketbollit (FSHB). Gjatë secilit edicion garues, FBK organizon mbi 1000 ndeshje në të dyja konkurrencat (femra dhe meshkuj) dhe për të gjitha grupmoshat.

Krahas organizimit dhe drejtimit të garave në nivel kombëtar dhe mbarëkombëtar, që nga pranimi në FIBA në vitin 2015, FBK ka paraqitur për gara dhe përfaqësuar Republikën e Kosovës në të gjitha nivelet e garimit dhe kategoritë në të cilat ka të drejtë të marrë pjesë, përfshirë përfaqësueset U14, U16, U18 dhe U20 vajza dhe djem, përfaqësueset seniore të të dyja gjinive në basketboll dhe përfaqësueset U23 dhe seniore të të dyja gjinive në disiplinën 3x3.

Që nga viti 2018, çdo verë FBK organizon Kampionate Evropiane të FIBA-s për grupmoshat e reja, ndërsa në vitin 2022 dhe 2023 ka organizuar edhe garat prestigjioze të FIBA 3x3 Challenger, FIBA Ligës së Kombeve 3x3 dhe FIBA Kampionatit Evropian U23 në disiplinën e basketbollit 3x3, të cilat është zotuar t'i organizojë edhe në vitet 2024 dhe 2025.

Federata e Basketbollit e Kosovës është pjesë e programeve të FIBA-s, siç janë FIBA TIME OUT Program, FIBA Executive Marketing Programme, FECC, FIBA Europe Girls Program, FIBA Youth Development Program, si dhe në programe të tjera edukuese dhe avancuese për stafin e zyrës ekzekutive në Komitetin Olimpik të Kosovës/ Solidaritetin Olimpik.



FBK ka të punësuar katërmbëdhjetë (14) persona të përkushtuar me orar të plotë pune dhe mëton të angazhojë edhe punonjës tjerë në të ardhmen për të zbatuar projekte e programe të tjera zhvillimore në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Kosovës, Kryetari i FBK-së mban postin e Anëtarit të Bordit Ekzekutiv të FIBA Europe si dhe Nënkyetarit të Komisionit për të Rinj për mandatin 2023-27, ndërsa Sekretarja e Përgjithshme e FBK është anëtare e Komisionit të FIBA World për 3x3 për mandarin 2023-2027 dhe të Komisionit të FIBA Europe për të Rinj për të njëjtin mandat.

FBK është federata e parë sportive në vend që ka miratuar Strategjinëⁱⁱ dhe Planin e Veprimit për periudhën 2021-25, duke krijuar kështu bazën afatmesme për zhvillimin e federatës dhe komunitetit të basketbollit në vend. Në këtë dokument strategjik, të cilin e ka hartuar dhe miratuar gjatë kohës së pandemisë kur aktivitetet sportive në vendin tonë ishin pezulluar në bashkëpunim të ngushtë me FIBA (si federata e parë e basketbollit në botë që ka përfituar nga granti i FIBA Plus), FBK ka përcaktuar misionin e saj për rritjen, zhvillimin dhe qeverisjen e mirë të basketbollit në Kosovë, nën vizionin që të bëhemi dhe mbesim sporti më i dashur në vend, duke iu përmbajtur dhe duke i avancuar më tej vlerat e veta: respektin, zellin, vizionin, pasionin dhe përkushtimin për fitore. Në Planin Strategjik 2021-25, FBK ka përcaktuar një sërë qëllimesh dhe ka elaboruar në detaje aktivitetet e parapara për arritjen e tyre, mes të cilave janë zhvillimi i basketbollit për të gjithë, avancimi i pozitës së femrave dhe grave në basketboll në të gjitha nivelet, avancimi dhe profesionalizimi i trajnerëve, ngritja e mëtejme e disiplinës 3x3, si dhe paraqitja më e mirë e vendit tonë në skenën ndërkombëtare në të gjitha nivelet, të cilat janë zbërthyer edhe në këtë Program.



VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT E FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

VIZIONI

**Ta avancojmë basketbollin në Kosovë për tu bërë histori suksesi
në të gjitha nivelet.**

Kjo nënkupton:

*Të kemi 4000 lojtarë të regjistruar deri më 31 dhjetor 2025
Të kualifikohemi në një turne të FIBA-s (meshkujt ose femrat) deri më 31
dhjetor 2025
Të bëhemi sporti më i dashur në Kosovë
Të kemi stabilitet financiar dhe të shtojmë burimet e të ardhurave*

MISIONI

**Ta qeverisim, zhvillojmë dhe rrisim sportin e basketbollit
në Kosovë.**



VLERAT

Vlerat e Federatës së Basketbollit të Kosovës janë:

VIZIONI - Jemi vizionarë, kreativë, kemi ëndrra të mëdha dhe gjithmonë mendojmë se si ta bëjmë basketbollin në vendin tonë më tërheqës për të gjithë pjesëmarrësit dhe grupet e interesit;

PASIONI - Jemi të apasionuar pas basketbollit, komunitetit dhe vendit tonë;

FITORJA - Jemi fitues dhe përpigemi të promovojmë dhe zhvillojmë mentalitetet të fituesit tek lojtarët, zyrtarët, grupet e interesit dhe partnerët tanë;

RESPEKTI - Respektojmë shumëllojshmërinë dhe lirinë e mendimit dhe gjithmonë udhëhiqemi nga parimet e gjithë përfshirjes, transparencës dhe përgjegjësisë;

ZELLI - Punojmë me zell dhe angazhohemi për ta përmbushur misionin dhe vizionin tonë, duke besuar se asgjë nuk e zëvendëson punën e zellshme;



QËLLIMET

Qëllimet e Federatës së Basketbollit të Kosovës

Emri i Federatës:	Federata e Basketbollit e Kosovës	
Qëllimet e përgjithshme	Përgjegjësia individuale	Komisioni Mbikëqyrës
Performanca e lartë (plani teknik, zhvillimi i lojtarëve dhe trajnerëve, zhvillimi i garave)	Drejtori Teknik	Bordi i FBK-së
Rritja e të ardhurave dhe stabiliteti financiar	Kryetari	Bordi i FBK-së
Basketbolli për të gjithë (rritje 100% e pjesëmarrjes përmes komunitetit, klubeve dhe shkollave)	Drejtori Teknik	Bordi i FBK-së
Vajzat dhe Gratë në basketboll	Sekretari i Përgjithshëm	Bordi i FBK-së
Fuqizimi i klubeve tona	Sekretari i Përgjithshëm	Bordi i FBK-së



HYRJE

Një Plan i Veprimit të Federatës së Basketbollit të Kosovës për vitin 2024 është vlerësuar si i domosdoshëm në mënyrë që të bëhet edhe renditja e aktiviteteve të FBK-së, por edhe të parashtrihen objektivat strategjike, si dhe njësia matëse e këtyre objektivave, gjithnjë duke u bazuar në Planin Strategjik të FBK-së 2021-2025.

Federata e Basketbollit e Kosovës në kalendarin e saj të vitit 2024 numëron një numër të madh të aktiviteteve vendore e ndërkombëtare, të cilat sigurisht se e kanë një kosto të madhe, për të cilën mban përgjegjësi Bordi i FBK-së në krye me Kryetarin e FBK-së, konform Statutit të FBK-së, derisa për implementimin e këtyre aktiviteteve do të përkujdeset Zyra Ekzekutive e FBK-së në krye me Sekretaren e Përgjithshme të FBK-së, gjithnjë në bashkëpunim me të gjitha Grupet e Interesit të FBK-së.



GRUPET E INTERESIT

Grupet e Interesit të Federatës së Basketbollit të Kosovës janë:

- Kuvendi;
- Klubet;
- Shoqatat;
- Komisionet;
- Basketbollistë/et;
- Trajnerët/et, referët/et;
- Bordi Ekzekutiv;
- Zyra Ekzekutive;
- FIBA;
- Federatat Nacionale;
- Organizatat e tjera sportive jashtë vendit;
- Ekspertët e jashtëm dhe të brendshëm;
- Federatat dhe organizatat tjera sportive në Kosovë;
- Qeveria e Republikës së Kosovës;
- Komunitat;
- Shkollat;
- Policia e Republikës së Kosovës;
- Partnerët medial, Art Motion dhe Kujtesa;
- Mediat e shkruara dhe elektronike;
- Partnerët/Sponsorët;
- Tifozët e basketbollit;



ANALIZA SWOT

Pikët e forta

- ✓ Basketbolli, sport i popullarizuar;
- ✓ Vullnet i madh nga FBK për të implementuar Planin Strategjik;
- ✓ Rritja e interesimit për basketbollin;
- ✓ Imazhi pozitiv i FBK-së në Qeverinë e Kosovës;
- ✓ Imazh pozitiv i FBK-së në FIBA;
- ✓ Imazhi pozitiv i FBK-së tek partnerët/sponsorët e saj;
- ✓ Pjesëmarrja e Përfaqësueseve të Kosovës në gara zyrtare të FIBA-s;
- ✓ Zyra Ekzekutive në rritje;
- ✓ Edukimi profesional i anëtarëve të zyrës ekzekutive.

Pikët e dobëta

- ✓ Mungesa e infrastrukturës sportive;
- ✓ Mungesa e trajnerëve 100% të fokusuar në basketboll (senior, kategori të reja, minibasketboll, 3x3);
- ✓ Mungesa e ekspertëve vendor;
- ✓ Mungesa e lojtarëve të profilizuar për 3x3;
- ✓ Mungesa e sukseseve të Përfaqësueseve të Kosovës në gara zyrtare të FIBA-s;
- ✓ Deficiti financiar;
- ✓ Lufta për sport të pastër.

Mundësitë

- ✓ Përkrahja nga institucionet;
- ✓ Rrjetet sociale, interneti dhe uebsite;
- ✓ Projektet zhvillimore dhe ato për qeverisje të mirë dhe sport të pastër;
- ✓ Bashkëpunim i mirë i FBK-së me Federatat tjera Nacionale;
- ✓ Zhvillimi dhe fuqizimi i klubeve të FBK-së;
- ✓ Fuqizimi i basketbollit 3x3;
- ✓ Investimi në burimet njerëzore;
- ✓ Komunikimi me të gjitha grupet me interes (në veçanti me klubet).

Kërcënimet

- ✓ Rritja e konkurrencës në raport me sportet tjera;
- ✓ Mos-sigurimi i sponsorëve konform planit;
- ✓ Mos-sigurimi i përkrahjes financiare nga qeveria sipas planit;
- ✓ Mungesa e komunikimit me klubet/tifozët e tyre;
- ✓ Lufta për sport të pastër;
- ✓ Covid19.



OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Objektivat Strategjike të Federatës së Basketbollit të Kosovës për vitin 2024 janë:

- Zhvillimi dhe fuqizimi i klubeve anëtare të FBK-së nëpërmjet programeve të qeverisjes së mirë;
- Masivizimi i basketbollit 3x3 në shkolla dhe basketbollit 3x3 elitare;
- Rritja e të hyrave në FBK;
- Zvogëlimi i deficit financiar;
- Integriteti në Sport (drejtësia, gjithë përfshirja, ndershmëria, besimi, vlerat, etika, morali, besimet, respekti dhe loja korrekte);
- Fillimi i zbatimit të projektit "Safeguarding the Future"
- Fuqizimi i projekteve FIBA Europe Youth Development Fund, FIBA Europe Girls Program, Jr. NBA, Mini-Basketbollit;
- Vazhdimi i edukimit të trajnerëve/eve të basketbollit në Kosovë;
- Rritja e numrit të refereve femra;
- Rritja e numrit të administratoreve femra;
- Organizimi dhe bashkë-organizimi i 5 eventeve të FIBA dhe FIBA 3x3 në nivelin e kërkuar;
- Promovimi i Kosova U16 Meshkujt në Divizionin B;
- Identifikimi i lojtarëve/e vendor/e nga jashtë vendi - potencial për Përfaqësueset e Kosovës në të dyja konkurrencat;
- Fuqizimi i imazhit të Përfaqësueseve në të dyja konkurrencat;
- Investimi në burimet njerëzore të FBK-së;
- Vazhdimi i projektit të Ligës Unike në të dyja konkurrencat;
- Zhvillimi i mëtutjeshëm i brendit/markës të Federatës së Basketbollit të Kosovës;
- Rritja e numrit të projekteve të fituara në Erasmus+ dhe organizimi i projekteve të përbashkëta me Ambasadat e huaja e organizata të tjera në Kosovë për promovimin e vlerave të përbashkëta.



1. GARAT E FBK-SË

- Organizimi i garave në kategorinë seniore (dy konkurrencat);
- Organizimi i garave në kategoritë e reja (dy konkurrencat);
- Organizimi i Final 8 Kupës së Kosovës (dy konkurrencat);
- Organizimi i Superkupës së Kosovës (dy konkurrencat);
- Organizimi i garave të veteranëve/eve;
- Bashkë-organizimi i garave në Ligën UNIKE (dy konkurrencat).

1.1. Plani i Veprimit

Veprimi (Çfarë)	Detyra (Si)	Përgjegjësi (Kush)	Afatet (Kur)	Burime
<i>Organizimi i garave</i>	<i>Nëpërmjet ligave të ndara në kategori dhe në dy konkurrencat</i>	<i>Komisioni i Garave</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>	<i>FBK FSHB</i>

1.2. Kontrolli dhe Vlerësimi

Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat (Kur)	Përgjegjës
<i>Organizimi dhe mbarëvajtja e mirëfilltë e garave, ngritja e cilësisë, dhe masivizimi i sportit të basketbollit</i>	<i>Klubet Trajnerët Basketbollistët Basketbollistet</i>	<i>Përfshirja e basketbollit nëpër të gjitha regjionet e Kosovës dhe më gjerë</i>	<i>Në bazë të informatorëve dhe raporteve të Komisioni të Garave dhe Komesarëve të Garave</i>	<i>Në baza javore, mujore, vjetore</i>	<i>Bordi i FBK-së</i>



2. KLUBET DHE ANËTARËT E SAJ

- Fuqizimi i kriterëve për licencim të klubeve;
- Organizimi i seminareve për klubet (Qeverisje të Mirë/Përgjegjësia, Llogaridhënia, Ndërgjegjësimi, Paanshmëria, Transparenca; Integriteti në Sport, Edukimi për Anti-doping, Menaxhim Sportiv etj.);
- Garat ndërkombëtare;
- Shpërblimet;
- Donacionet (veshmbathje sportive, topa, etj.);
- Fuqizimi i bashkëpunimit/komunikimit me klubet;
- Organizimi i takimeve në mes klubeve dhe krerëve të FBK-së (para fillimit të edicionit, gjatë edicionit dhe pas përfundimit të edicionit).

2.1. Plani i Veprimit

Veprimi (Çfarë)	Detyra (Si)	Përgjegjësi (Kush)	Afatet (Kur)	Burime
<i>Fuqizimi i klubeve tona</i>	<i>Seminare, Punëtori, Klinika</i>	<i>Sekretari i Përgjithshëm</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>	<i>FIBA; FBK; MKRS; Partnerët/Sponsorët</i>

2.2. Kontrolli dhe Vlerësimi

Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat Kur	Përgjegjës
<i>Zhvilli dhe fuqizimi i klubeve tona, ngritja profesionale e klubeve tona</i>	<i>Klubet dhe anëtarët e saj</i>	<i>Të kemi klube sa më të strukturuar dhe shembull për qeverisje të mirë</i>	<i>Në bazë të raporteve, takimeve, e organizimeve të tjera</i>	<i>Në baza javore, mujore, vjetore</i>	<i>Bordi i FBK-së</i>



3. AKTIVITETET E PËRFAQËSUESEVE TË KOSOVËS

- Pjesëmarrja e Kosova A në para-kualifikimet për FIBA Kupën e Botës;
- Pjesëmarrja e Kosova A Femrat në FIBA Kampionatin Evropian të Shteteve të Vogla;
- Pjesëmarrja e Përfaqësueseve të Reja në FIBA Kampionate Evropiane: U16, U18 dhe U20 në konkurrencën e meshkujve dhe U16 dhe U18 në konkurrencën e femrave;
- Seminaret për anti-doping për basketbollistët/basketbollistet dhe shtabin teknik të Përfaqësueseve;

3.1. Plani i Veprimit

Veprimi (Çfarë)	Detyra (Si)	Përgjegjësi (Kush)	Afatet (Kur)	Burime
<i>Pjesëmarrja e Përfaqësueseve të Kosovës në gara zyrtare të FIBA-s</i>	<i>Nëpërmjet FIBA Kampionateve Evropiane dhe para-kualifikimeve për FIBA Kupën e Botës</i>	<i>Menaxheri i Përfaqësueseve të Kosovës</i>	<i>Janar Dhjetor</i>	<i>FBK MKRS FIBA Sponsorët</i>

3.2. Kontrolli dhe Vlerësimi

Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat Kur	Përgjegjës
<i>Paraqitja sa më e mirë në gara ndërkombëtare dhe synimi për sukses</i>	<i>Trajnerët Basketbollistët Basketbollistet</i>	<i>Ngritja e cilësisë tek basketbollistët/et e reja të Kosovës, por edhe tek trajnerët</i>	<i>Në bazë të raporteve të Menaxherit të Përfaqësueseve dhe trajnerëve</i>	<i>Në baza javore, mujore, vjetore</i>	<i>Bordi i FBK-së</i>



4. AKTIVITETET E BASKETBOLLIT 3X3

- Organizimi i garave shkollore 3x3;
- Organizimi i FIBA 3x3 Europe Cup Qualifier;
- Pjesëmarrja në gara të FIBA 3x3 në nivel të Përfaqësueseve (meshkuj/femra);
- Bashkëorganizimi i FIBA 3x3 Challenger Prishtina;
- Bashkëorganizimi i FIBA 3x3 Women's Series Prishtina;
- Profilizimi i basketbollistëve/eve për 3x3;
- Profilizimi i trajnerëve/eve për 3x3.
- Bashkëpunimi me promotorë të ndryshëm për organizimin e turneve në qytete të ndryshme të Kosovës;

4.1. Plani i Veprimit

Veprimi (Çfarë)	Detyra (Si)	Përgjegjësi (Kush)	Afatet (Kur)	Burime
<i>Organizimi i garave dhe pjesëmarrja në gara zyrtare të FIBA 3x3</i>	<i>Nëpërmjet bashkëpunimit me grupe të interesit brenda dhe jashtë vendit</i>	<i>Menaxherja e Projekteve</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>	<i>FBK MKRS KOK FIBA Sponsorët</i>

4.2. Kontrolli dhe Vlerësimi

Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat Kur	Përgjegjës
<i>Organizimi sa më profesional i garave dhe paraqitja sa më e mirë për në gara ndërkombëtare</i>	<i>Trajnerët Basketbollistët Basketbollistet Organizatorët</i>	<i>Zhvillimi dhe fuqizimi i basketbollit 3x3 në vendin tonë</i>	<i>Në bazë të raporteve të Koordinatorit Nacional të 3x3</i>	<i>Në baza javore, mujore, vjetore</i>	<i>Bordi i FBK-së</i>



5. AKTIVITETET PËR TRAJNERËT

- Organizimi i edukimeve për trajnerët në bashkëpunim me FIBA-n;
- Organizimi i edukimeve për trajnerët e Mini-Basketbollit;
- Organizimi i seminareve/klinikave para-sezonale;
- Pjesëmarrja në FIBA Konventën e Mini-Basketbollit;
- Pjesëmarrja në FIBA U14 Get Together;
- Pjesëmarrja në programin për trajnerë të FIBA-s, FECC;
- Përgatitja e Nivelit 2;

5.1. Plani i Veprimit

Veprimi (Çfarë)	Detyra (Si)	Përgjegjësi (Kush)	Afatet (Kur)	Burime
Zhvillimi dhe edukimi i trajnerëve kosovarë Rritja e numrit të trajnerëve të kualifikuar	Nëpërmjet klinikave, seminareve brenda dhe jashtë vendit	Drejtori Teknik	Janar - Dhjetor	FBK MKRS FIBA Sponsorët Partnerët

5.2. Kontrolli dhe Vlerësimi

Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat Kur	Përgjegjës
Edukimi profesional i trajnerëve	Trajnerët Drejtori Teknik i FBK-së	Të kemi trajnerë të edukuar	Në bazë të raporteve të Drejtorit Teknik	Në baza javore, mujore, vjetore	Bordi i FBK-së



6. AKTIVITETET PËR GJYQTARË/VËZHgues

- Organizimi i FIBA SCOD Klinika para-sezonale;
- FIBA PRNC Klinika;
- FIBA SCOD Kampi;
- Play-Off Klinika;
- Klinika për FIBA Referee Instructor;
- Pjesëmarrja e gjyqtarëve kosovarë në ndarjen e drejtësisë në FIBA Kampionate Evropiane të gjeneratave të reja;
- Kampi Veror për gjyqtarë;
- SCOD seminari për gjyqtarë dhe vëzhgues;
- Mbajtja e Klinikës për Statistika;
- FIBA FRIP Level 1;
- Pjesëmarrja e Technical Delegate në edukime profesionale dhe nominimi në ndeshje ndërkombëtare;
- Vazhdimi i punës me referët/delegatët e rinj.

6.1. Plani i Veprimit

Veprimi (Çfarë)	Detyra (Si)	Përgjegjësi (Kush)	Afatet (Kur)	Burime
<i>Zhvillimi i gjyqtarëve kosovarë/delegatëve</i>	<i>Nëpërmjet klinikave, seminareve brenda dhe jashtë vendit, si dhe në ndarje të drejtësisë në gara zyrtare të FIBA-s</i>	<i>Instruktori Nacional i FBK-së</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>	<i>FBK MKRS FIBA Sponsorët</i>



6.2. Kontrolli dhe Vlerësimi

Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat Kur	Përgjegjës
Të rritet për çdo vit numri i gjyqtarëve kosovarë me thirrje të FIBA-s dhe "profesionalizmi" i gjyqtarëve dhe vëzhguesve të rinj	Gjyqtarët Vëzhguesit	Të kemi gjyqtarë dhe vëzhgues cilësorë	Në bazë të raporteve të Instrukturit Nacional si dhe evoluimit personal të gjyqtarëve	Në baza javore, mujore, vjetore	Bordi i FBK-së



7. PROJEKTET ZHVILLIMORE

- 3x3 në shkolla/Programi 'Sport në Shkolla'
- FIBA Europe Youth Development Fund (YDF Europe)
- FIBA Europe Girls Program (kampanja Her World, Her Rules)
- Minibasketbolli;
- Promise (Erasmus+);
- Jr. NBA Kosova;
- Kampi Nacional i FBK-së;
- Kampi në Postojna të Sllovenisë.

7.1. Plani i Veprimit

Veprimi (Çfarë)	Detyra (Si)	Përgjegjësi (Kush)	Afatet (Kur)	Burime
Masivizimi Identifikimi Mbetja në basketboll Zhvillimi Organizimi	Nëpërmjet pjesëmarrjes në turne, kampe, klinika, si dhe organizimeve në vendin tonë të aktiviteteve me karakter ndërkombëtar	Drejtori Teknik	Janar - Dhjetor	FBK MKRS FIBA Komunat NBA



7.2. Kontrolli dhe Vlerësimi

Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat Kur	Përgjegjës
<p><i>Të rritet numri i djemve dhe vajzave që e praktikojnë basketbollin</i></p> <p><i>Të rritet numri i djemve dhe vajzave të moshës prej 5 deri në 10 vjeç që e praktikojnë basketbollin</i></p>	<p><i>Koordinatorët/et</i></p> <p><i>Trajnerët/et</i></p> <p><i>Basketbollistët</i></p> <p><i>Basketbollistet</i></p>	<p><i>Të rritet numri i fëmijëve që e praktikojnë basketbollin dhe të atyre që qëndrojnë në basketboll</i></p>	<p><i>Në bazë të raporteve të Drejtorit Teknik</i></p>	<p><i>Në baza javore, mujore, vjetore</i></p>	<p><i>Bordi i FBK-së</i></p>



8. PROJEKTI "SAFEGUARDING THE FUTURE"

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) është fituese e projektit "Safeguarding the Future" (Erasmus +), në të cilin projekt FBK është koordinatore, përderisa partnere të saj në janë Federata e Basketbollit të Estonisë, Federata e Basketbollit të Bullgarisë dhe Shoqatën e Trajnerëve të Basketbollit të Kosovës (SHTBK).

"Safeguarding the Future" është një projekt që synon të krijojë mekanizma në Kosovë, Estoni dhe Bullgari që sigurojnë një përvojë basketbolli të sigurt, pozitive dhe argëtuese për të gjithë njerëzit e përfshirë në basketboll, me theks të veçantë tek fëmijët dhe të rinjtë. Qëllimi kryesor i projektit është të ndërmarë veprime për të mbrojtur njerëzit nga çdo lloj abuzimi në basketboll. Për ta bërë këtë, projekti do të krijojë sisteme mbrojtëse për të gjitha federatat kombëtare të basketbollit, në Kosovë, Estoni dhe Bullgari. Ky projekt do të zgjasë 18 muaj, duke filluar nga janari 2024 deri në qershor 2025.

Zbatimi i një projekti me temën e "Safeguarding" është thelbësor për krijimin e një mjedisi të sigurt, gjithëpërfshirës dhe të respektueshëm për sportistët, mbrojtjen e mirëqenies së tyre dhe ruajtjen e vlerave të sjelljes sportive dhe lojës së ndershme. Implementimi i një projekti të tillë ndihmon organizatat sportive të përmbushin detyrimet ligjore, të ruajnë reputacionin e tyre dhe të promovojnë zhvillimin afatgjatë të sportistëve.

8.1. Plani i Veprimit

Veprimi (Çfarë)	Detyra (Si)	Përgjegjësi (Kush)	Afate (Kur)	Burime
<i>Fillimi i punës në implementimin e projektit</i>	<i>Nëpërmjet takimeve, hulumtimeve, angazhimit të ekspertëve, punëtorive,</i>	<i>Sekretari i Përgjithshëm</i>	<i>Janar 2024 Qershor 2025</i>	<i>FBK MKRS FIBA KOK</i>



8.2. Kontrolli dhe Vlerësimi

Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat Kur	Përgjegjës
<i>Hartimi i politikave të mbrojtjes</i>	<i>Ekipi që punon në projekt dhe grupet e tjera të interesit</i>	<i>Krijimi i një mjedisi të sigurt për të gjithë të përfshirët në sport/basketboll</i>	<i>Në bazë të raporteve të aktiviteteve</i>	<i>Në bazë të aktiviteteve</i>	<i>Bordi i FBK-së</i>



9. NGRITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE

- Edukimi dhe zhvillimi i stafit të zyrës ekzekutive në programet e FIBA-s, KOK-ut, KON-it, UEFA/FIFA etj.;
- Përfaqësimi i FBK-së në konferenca të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

9.1. Plani i Veprimit

Veprimi (Çfarë)	Detyra (Si)	Përgjegjësi (Kush)	Afate (Kur)	Burime
<i>Investimi në kuadro dhe kthimi prapa i këtij investimi</i>	<i>Nëpërmjet pjesëmarrjes në Programe, Punëtori, Klinika dhe Seminare</i>	<i>Sekretari i Përgjithshëm</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>	<i>FBK MKRS FIBA KOK</i>

9.2. Kontrolli dhe Vlerësimi

Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat Kur	Përgjegjës
<i>Të rritet cilësia tek kuadrot</i>	<i>Stafi i zyrës ekzekutive</i>	<i>Të arrihet profesionalizmi</i>	<i>Në bazë të raporteve të aktiviteteve</i>	<i>Në bazë të aktiviteteve</i>	<i>Bordi i FBK-së</i>



10. UDHËTIMET ZYRTARE

- Pjesëmarrja e Kryetarit të FBK-së në mbledhjet e Bordit të FIBA Evropës në cilësinë e anëtarit të Bordit;
- Pjesëmarrja e Kryetarit dhe Sekretares së Përgjithshme në takimet e punës të FIBA Europe Youth Commission;
- Pjesëmarrja në Asamblenë e Përgjithshme të FIBA Europe;
- Pjesëmarrja në Takimin Vjetor të Sekretarëve të Përgjithshëm të FIBA Evropës;
- Pjesëmarrja në shortin e Përfaqësuesve të Reja;
- Pjesëmarrja në aktivitetet e Përfaqësuesve të Reja;
- Pjesëmarrja në Punëtoritë e Junior NBA.

10.1. Plani i Veprimit

Veprimi (Çfarë)	Detyra (Si)	Përgjegjësi (Kush)	Afatet (Kur)	Burime
<i>Udhëtime me karakter të rrjetëzimit dhe fuqizimit të vetë FBK-së</i>	<i>Nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete</i>	<i>Sekretari i Përgjithshëm</i>	<i>Mars Prill Maj Nëntor Dhjetor</i>	<i>FBK MKRS FIBA</i>

10.2. Kontrolli dhe Vlerësimi

Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat Kur	Përgjegjës
<i>Prezantim sa më i mirë i FBK-së</i>	<i>Zyrtarët e FBK-së</i>	<i>Bashkëpunimi me Federatat tjera Nacionale Zhvillimi i projekteve të përbashkëta</i>	<i>Në bazë të raporteve të aktiviteteve</i>	<i>Në bazë të aktiviteteve</i>	<i>Bordi i FBK-së</i>



11. ORGANIZIMI I EVENTEVE DHE AKTIVITETET TJERA

- Organizimi i FIBA Kampionatit Evropian për Shtete të Vogla për Femra - Senioret në Prishtinë;
- Organizimi i FIBA U18 Kampionatit Evropian, Divizioni C për Femra në Prishtinë;
- Organizimi i FIBA 3x3 Europe Cup Qualifier (dy konkurrencat) në Prishtinë;
- Bashkë-organizimi i FIBA 3x3 Women's Series në Prishtinë (organizator klubi 3x3 Prishtina);
- Bashkë-organizimi i FIBA 3x3 Challenger Prishtina në Prishtinë (organizator klubi 3x3 Prishtina);
- Organizimi i Kuvendit të Punës të FBK-së;
- Organizimi i Kuvendit Zgjedhor të FBK-së;
- Organizimi i Superkupës së Kosovës;
- Organizimi i Final 8 Kupës së Kosovës;
- Organizimi i Final Four të Ligës Unike për Femra;
- Organizimi i Final 8 Ligës Unike për Femra;
- Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta me partnerët/sponsorët e FBK-së;
- Pjesëmarrja me veteranët/et në aktivitete jashtë vendit.

11.1. Plani i Veprimit

Veprimi (Çfarë)	Detyra (Si)	Përgjegjësi (Kush)	Afate (Kur)	Burime
<i>Pjesëmarrja e vazhdueshme e FBK-së në organizime të eventeve të FIBA-s</i>	<i>Nëpërmjet përgatitjes së punës profesionale</i>	<i>Sekretari i Përgjithshëm</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>	<i>- FBK - MKRS - FIBA - Grupe të tjera të interesit</i>



11.2. Kontrolli dhe Vlerësimi

Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat Kur	Përgjegjës
<i>Të 'servojmë' evente të organizimit në nivel të lartë</i>	<i>Stafi organizativ dhe grupet e tjera të interesit të përfshira në organizim të eventeve</i>	<i>Të sigurohen të hyra financiare nëpërmjet organizimit të këtyre eventeve</i>	<i>Në bazë të raporteve</i>	<i>Në bazë të aktiviteteve</i>	<i>Bordi i FBK-së</i>



12. AKTET NORMATIVE TË FBK-SË

Miratimi i akteve normative për edicionin e ardhshëm garues:

- Rregullorja e Përfaqësueseve të Kosovës
- Propozicionet e Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2024/25
- Propozicionet e Garave të Ligave të Kategorive të Reja, Edicioni 2024/25
- Rregullorja për Regjistrim dhe Kalim në FBK, Edicioni 2024/25
- Rregullorja për Licencim dhe Garim në FBK, Edicioni 2024/25
- Propozicionet e Garave të Kupës së Kosovës
- Udhëzues për Organizimin e Final 8 Kupës së Kosovës
- Udhëzues për Organizimin e Superkupës së Kosovës
- Propozicionet e Garave për Kategorinë e Veteranëve, Edicioni 2024/25
- **Përditësimi dhe miratimi i akteve tjera normative sipas nevojës.**

12.1. Plani i Veprimit

Veprimi (Çfarë)	Detyra (Si)	Përgjegjësi (Kush)	Afate (Kur)	Burime
<i>Përditësimi dhe miratimi i akteve normative të nevojshme për mbarëvajtjen e garave</i>	<i>Nëpërmjet përgatitjes së punës profesionale</i>	<i>Sekretari i Përgjithshëm; Këshilltarja Ligjore për Sport (në koordinim me Komesarin e Garave dhe të tjerë)</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>	<i>/</i>



12.2. Kontrolli dhe Vlerësimi

Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat Kur	Përgjegjës
<i>Të jemi në hap me nevojat dhe rrethanat aktuale rreth mbarëvajtjes dhe administrimit të garave</i>	<i>Përshatshmëria e akteve normative me gjendjen dhe rrethanat aktuale në gara/aktivitete</i>	<i>Zhvillimi sa më i mirë i aktiviteteve të FBK-së</i>	<i>Në bazë të raporteve, rekomandimeve nga Komisionet e FBK-së apo personave të tjerë me interes</i>	<i>Para fillimit të edicionit vijues; Sipas nevojës</i>	<i>Bordi i FBK-së</i>



REKOMANDIMET

Është e rëndësisë së veçantë që Bordi Ekzekutiv i FBK-së dhe Zyra Ekzekutive ta marrin seriozisht qasjen ndaj implementimit të këtij plani, sepse vetëm në këtë mënyrë të gjitha ato që janë shkruar në këtë plan mund të realizohen dhe në fund të vitit do të mund të bëjmë evoluimin e implementimit të Planit Strategjik të FBK-së.

Federata e Basketbollit e Kosovës si institucion serioz dhe përgjegjësi kryesor për zhvillimin e basketbollit në vendin tonë, do të vazhdoj të shërbejë si rol model, jo vetëm për klubet dhe gjithë anëtarët e saj, por edhe për të gjitha Federatat Sportive dhe organizatat tjera sportive në vendin tonë.

Është e rëndësisë së veçantë që klubet e basketbollit dhe shkollat, apo shoqatat anëtare të saj të marrin shembull nga FBK, dhe në këtë mënyrë të vazhdojnë edhe ato me hartimin dhe implementimin e Qeverisjes së Mirë (Parimet: Përgjegjësi, Llogaridhënie, Ndërgjegjësim, Paanshmëri, Transparencë).



PËRMBLEDHJE

Ky plan i veprimit është bazuar në Planin Strategjik të FBK-së 2021-2025. Plani përshkruan aktivitetet e përfshira në përbushjen e objektivave specifike brenda një afati kohor të caktuar.

Federata e Basketbollit e Kosovës është e gatshme edhe për një tjetër vit të suksesshëm të basketbollit në Kosovë, por për të realizuar një gjë të tillë ne kemi nevojë për përkrahjen e të gjitha Grupeve të Interesit, të cilat luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e basketbollit në vendin tonë, sepse vetëm së bashku ne mund ta zhvillojmë sportin tonë të dashur.

Ne besojmë fuqishëm se basketbolli është një platformë dhe nxitës për ndryshim. Çdo gjë që ne e bëjmë në Federatën e Basketbollit të Kosovës ka ndikim në mijëra njerëz, si dhe ka ndikim në zhvillimin e vendit tonë. Është përgjegjësia jonë për të vazhduar punën për rritjen e ndikimit të sportit tonë të zemrës, basketbollit.



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

ⁱ Superliga e Kosovës; Superliga e Femrave; Liga e Parë e Femrave; Liga e Parë e Meshkujve; Liga e Dytë e Meshkujve; Superliga U18; Superliga U16; Superliga U14; Liga U18, Liga U16 Lindje; Liga U16 Perëndim; Liga U16 Vajzat; Liga U14; Liga U14 Vajzat, Liga U12 Lindje; Liga U12 Perëndim, dhe Liga e Veteranëve.

ⁱⁱ Për më shumë informata, shih: <https://basketbolli.com/files/PLANISTRATEGJIKFBK%202021-2025.pdf>